

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konstitucionalisti Daci: Ja si mund të zhbëhet vendimi i Hagës - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/konstitucionalisti-daci-ja-si-mund-te-zhbehet-vendimi-i-hages/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 20:33:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:27:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	476c5ad0d8c29c0963119e325da4a6153566d9274a63b6cf7ed9a808aae4dc28
TEKSTI	e4f60f8cd612b04169bb03b506e54d55d2e816336a2a58bb08d93e4149d1ec9b
PAMJA	d88cfd75295e62fbc1b7ddc57170e4a37ef95adfde85b7881e2d6ff79e8bfd7c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	20c7739304eacb33c5264683cb255e133e715176a983d1813ca5f7ded30d2d7a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbd
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/20c7739304eacb33c5264683cb255e133e715176a983d1813ca5f7ded30d2d7a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Protesta në Tiranë Jordan Daci Ardit Bido Mark Rutte

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

Konstitucionalisti Daci: Ja si mund të zhbëhet vendimi i Hagës



16 Shtator 2026 | 22:27

Jordan Daci jurist, ka folur në "Now" lidhur me mundësinë e ndryshimit të vendimit në Apel sa i përket dënimit me 81 vite burg në total për 4 ish-krerëve të UÇK-së.

Juristi thekson se vendimi i shkallës së parë mund të ndryshojë ose të zhbëhet nëpërmjet rrugëve ligjore të ankimimit.

"Mund të ndryshojë, mund të zhbëhet, por duhet të kemi parasysh që ky vendim për individin është thjesht vendim gjyqësor. Për Kosovën, në raport me palët e treta, nuk është vetëm vendim gjyqësor, është edhe çështje politiko-ndërkombëtare. Kështu që gjëja komplikohet në momentin kur dilet nga një vendim gjyqësor dhe merr edhe trajta të tjera, të cilat padyshim nuk bazohen në parimet dhe nuk udhëhiqen nga të njëjtat rregulla dhe morale, të themi, siç ka vendimi gjyqësor.

Në këtë aspekt, normalisht rruga e vetme normale për t'u zhbërë ky vendim është ndjekja e rrugës së ankimit: fillimisht në Apel, që ata e kanë të posaçëm, dhe pastaj edhe në Gjykatën e Lartë që janë vetëm tre vetë, pra nuk ka short, dhe pastaj po tre të tjerë që është Gjykata Kushtetuese", tha ai.

Daci thekson se masat e dënimit të dhëna ishin tërësisht joproporcionale, veçanërisht nëse krahasohen me vendimet e mëparshme të Tribunalit të Hagës për krime lufte në ish-Jugosllavi.

"Masat e dënimit ishin totalisht joproporcionale me çfarë kemi parë po të shohim edhe vendimet e Tribunalit të Hagës për kasapët e Ballkanit, jo më për këta që tek e fundit nuk kanë kryer krime lufte pavarësisht se është përdorur emërtimi krime lufte, por nuk vjen se tani nuk mund të thuash janë kryer krime lufte dhe pastaj dënon për krime lufte, pra për krime që bëhen në periudhë lufte. Terminologjia është e pasaktë.

Por çfarë kanë bërë? Kur kanë bërë ligjin e posaçëm, këta e kanë bërë edhe ligj procedural, edhe kushtetues, i kanë futur edhe ca norma penale brenda dhe praktikisht Kodi Penal i Kosovës nuk është më 100%, por ka dhe shumë gjëra të tjera të cilat futen. Është një ligj i cili, edhe nëse do të jesh 100% dakord me idenë dhe me përmbajtjen, mënyra se si është shkruar është tepër joprofesionale dhe lë vend për manovra pafundësisht", thekson juristi.

Daci kritikon gjithashtu kohëzgjatjen e paraburgimit 6-7 vite, duke e quajtur atë një manovrë të paligjshme që shkel çdo standard ndërkombëtar të së drejtës.

"Ishte dhe manovra absolutisht e paligjshme: e mbajtën në paraburgim kaq gjatë. Në asnjë

LAJMI I FUNDIT

22:18 Lela: Rama shkoi me helikopter në Prishtinë për të bindur liderët e Kosovës për Gjykatën Speciale

22:10 Vuçiç i zhgënjyer nga Haga, Bido: U viktimizua, ishte shumë i kënaqur me vendimin

22:09 Djali i Hashim Thaçit reagon pas dënimit të të atit me 25 vjet burg: Kjo betejë nuk ka

SHPËRNDARJE BARUAR
ARTIKULLIN

22:04 'Liria ka emër', Dua Lipa reagon pas vendimit të Hagës ndaj ish-krerëve të UÇK-së

21:52 Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK, Bido: Një kartë e re në dorën e Serbisë kundër Kosovës

21:43 Protesta e 109-të mbyllet para Kryeministrit, organizatorët: Nesër në orën 10:00 para Kuvendit

TESTIM

vend demokratik te botes nje njeri nuk mund te mbanet ne paraburgim siç jane mbajtur këta gjashtë-shtatë vite. Nuk ka asnjë lloj standardi botëror. Edhe në Kinë, vendin më jodemokratik të botës po të shkosh, brenda dy viteve-tre të japin drejtim, ik, s'ka më. Edhe u dënua me 15 vite, pavarësisht se nuk i bëri se vdiq. Pra padyshim po. Unë mendoj që këtu ka vend për pafajësi", tha juristi Daci.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI
Vuçiç i zhgënjyer nga Haga, Bido: U viktimizua, ishte shumë i kënaqur me vendimin

Deputeti i Partisë Socialiste, Ardit Bido ka diksutuar në "Now" mbi vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për dënimin me 81 vite burg në total...

22:10 | 16/09/2026

AKTUALITET | VENDI
Qeveria miraton vendimet, 17 ushtarakë dhe një helikopter shqiptar në KFOR

Këshilli i Ministrave ka zhvilluar sot mbledhjen e radhës, ku miratoi disa vendime dhe projektligjin për krijimin dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë së...

20:45 | 16/09/2026

AKTUALITET | LAJMI I FUNDIT | VENDI
Në kërkim për zhdukjen e shisheve të verës nga vila e Ergys Agasit, arrestohet kushëriri i tij, Eno Agasi

Policia ka vënë në pranga pas 8 muajsh në arrati Eno Agasin, kushëririn e biznesmenit Ergys Agasi, për të cilin Gjykata e Tiranës kishte caktuar...

19:39 | 16/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontakttoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: